

Njoftim për përqendrim me të cilin CapVest Partners LLP, përmes Saxophone Germany BidCo GmbH, Mynih, Gjermani, do të fitojë kontroll të tërthortë mbi Nidda German Topco GmbH, Frankfurt am Main, Gjermani

(lënda nr. 08-146/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 03.10.2025, dhe i plotësuar më datë 09.10.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim, me të cilin CapVest Partners LLP, me adresë 100 Pall Mall, St. James’s, London SW1Y 5NQ, përmes Saxophone Germany BidCo GmbH, c/o SCUR24 Holding GmbH, Schwanthalerstraße 73, 80336 Munih, Gjermani, do të fitojë kontroll të tërthortë mbi Nidda German Topco GmbH, c/o Intertrust (Germany) GmbH, Grüneburgweg 58-62, 60322 Frankfurt am Main, Gjermani, së bashku me shoqëritë e saj të lidhura, Grupi STADA.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

CapVest Partners LLP është një firmë me kapital privat për tregun e mesëm, e fokusuar në industri me rezistencë të lartë ku kërkesa për produktin ose shërbimin nuk është diskrecionale. Sektorët kryesorë të CapVest janë produktet bazë të konsumit, kujdesi shëndetësor dhe shërbimet themelore.

CapVest investon kryesisht përmes dy fondeve private të kapitalit në biznese në të gjithë Evropën dhe Amerikën e Veriut.

CapVest Partners LLP dhe fondet e saj nuk kanë shoqëri të varura, filiale apo zyra përfaqësuese në Maqedoninë e Veriut. Përveç kësaj, asnjë nga shoqëritë e portofolit të kontrolluar të CapVest Partners LLP nuk ka shoqëri të varura, filiale apo zyra përfaqësuese në Maqedoninë e Veriut.

Një shoqëri e portofolit të kontrolluar nga CapVest Partners LLP ka gjeneruar qarkullim në Maqedoninë e Veriut përmes shitjeve ndërkufitare.

Grupi STADA është aktiv në industrinë farmaceutike me prani lokale në të gjitha tregjet e mëdha evropiane, si dhe në tregjet në rritje në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut, Azisë dhe Australisë.

Ofron një portofol produktesh të larmishme për një numër të madh fushash terapeutike, duke u fokusuar në tre segmentet e biznesit:

- Kujdesi Shëndetësor për Konsumatorët (barna pa recetë me status rregullator si barna pa recetë (ang."over the counter" (OTC)) ose pajisje mjekësore, kozmeceutikë dhe kozmetikë, vitamina, minerale dhe suplemente);
- Barna Gjenerike (barna me recetë që shiten me emrin ndërkombëtar të pa pronësuar); dhe
- Produkte Speciale (gjenerikë të markës, gjenerikë speciale, biosimilarë dhe trajtime inovative për sëmundje të rralla).

Grupi STADA ka një filial në Maqedoninë e Veriut - Hemofarm Komerc sh.p.k. Ajo është në pronësi shumice (99%) nga shoqëria e lidhur serbe, Hemofarm a.d. Hemofarm a.d., gjithashtu, ka një zyrë përfaqësuese në Maqedoninë e Veriut që merret me aktivitete promovuese.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu relevant për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si tregu i produkteve farmaceutike në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të hetimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

14.10.2025

Shkup